



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E FINANCEVE
DREJTORIA E PERGJITHESHME E DOGANAVE
Drejtoria e Procedurave Doganore dhe Borxhit

Adresa: Rruga e Durrësit, Laprake- Tirane

Tel 243920, 256547

Nr. 13573 Prot

Tiranë me 26/10. 2009

UDHEZIM

Nr. 7, date 26/10/2009

Mbi zbatimin e procedurave të magazinimit të perkohshëm të mallrave.

Me qellim zbatimin e sakte të procedurave doganore për paraqitjen e mallrave në dogane dhe magazinimin e perkohshëm të tyre deri në caktimin e një destinacioni doganor;

Për të bërë të mundur evidentimin e sakte të mjeteve dhe afateve respektive për caktimin e destinacionit, me qellim eliminimin e shkeljeve, mangesive e të metave të konstatuara në këtë drejtim;

Në zbatim të nenëve 75 – 78 të Ligjit Nr. 8449, datë 27.01.1999 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, pikave 112 – 117 të VKM Nr. 205, datë 13.04.1999 "Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor, i ndryshuar", Drejtori i Përgjithshëm i Doganave,

UDHEZON:

1. Perkufizime dhe percaktime:

Për qellime të këtij udhezimi, përdoren perkufizimet dhe percaktimet e mëposhtme:

1.1 "Magazinim i perkohshëm i mallrave" – do të thotë statusi që u jepet mallrave, të cilat janë paraqitur në dogane dhe për të nuk është caktuar ende një destinacion doganor.

1.2 "Ambjente për magazinim të perkohshëm" – quhet hapësira e rrethuar ose jo (parking) e caktuar nga autoritetet doganore për qëndrimin e mjeteve të transportit, të mallrave dhe që administrohet nga autoritetet doganore ose nga personat fizike apo juridike të autorizuar prej tyre.

1.3 "Dhenia e statusit mallra në magazinim të perkohshëm" kushtëzohet nga mbërritja dhe paraqitja e mallrave në zyrat doganore sipas kushtëzimeve dhe afateve të nenit 65 të Kodit Doganor si dhe depozitimit, pranë autoriteteve doganore, brenda afateve të percaktuara në nenin 68 të Kodit Doganor, të deklaratës përmbledhese.

- deklarate Permbledhese**” do te konsiderohet nje nga dokumentat e meposhtme:
- a) Manifesti i mjetit lundrues (per mallrat e mberritura ne rruge detare) dhe Liste-ngarkesa (bill of lading B/L)
 - b) Manifesti i mjetit ajror (per mallrat e mberritura ne rruge ajrore) dhe Liste-ngarkesa (AWB ose Master AWB)
 - c) Police-ngarkesa e transportit (CMR) per mallrat e mberritura ne rruge tokesore ose
 - d) Kopje e dokumentit te tranzitit (DAV) qe hartohet per zyren e destinacionit, per mallrat qe perpara paraqitjes ne nje zyre doganore kane levizur nen nje regjim traziti
 - e) Dhe/ose cdo dokument tjetër qe jep te dhena mbi llojin dhe sasine e mallrave.

2. “Vendqendrimi i mallrave dhe mjeteve ne statusin e magazinimit te perkohshem”

Vendqendrimi i **mallrave ne magazinim te perkohshem**, mund te jete i pozicionuar ne:

2.1 zonat doganore, te cilat jane ambjentet (parking) qe administrohen nga autoritetet e zyrove doganore perkatese, brenda hapësirave te miratuara si zona doganore kufitare dhe/ose ne brendesi te territorit doganor shqiptar (te brendshme).

2.1.1 Evidentimi i mallrave dhe mjeteve te tyre te transportit, ne keto zona doganore, behet me ane te regjistrimit te magazinimit te perkohshem (regjistri i mjeteve ne parking) sipas Aneksit 1/1 dhe 1/2, bashkangjitur ketij Udhezimi.

2.1.2 Ne varesi te struktures se zyres doganore, kryetari i zyres doganore ose pergjegjesi i Sektorit te pranimit caktojne ne menyre permanente ose mbi bazen e nje grafiku, doganiere pranimi te cilet, bejne pranimin e deklarates permbledhese dhe regjistrojne te dhenat e nevojshme ne regjistrin e siperpermendur.

2.1.3 Ne zyrat doganore kufitare detare, kjo procedure kryhet me dorezimin e manifestit te anijes dhe liste-ngarkeses (B/L) nga kapiteni dhe/ose marrjen e dokumentacionit nga grupi i praktikës ne det (rade).

2.1.4 Ne zyrat doganore kufitare aeroportuale, procedura e deklarimit permbledhes kryhet me dorezimin e manifestit te mjetit ajror dhe liste-ngarkeses (AWB dhe/ose Master AWB) nga transportuesi.

2.2 ambjentet e miratuara nga autoritetet doganore

2.2.1 Qendrimi i mallrave dhe mjeteve nen “statusin e mallrave ne magazinim te perkohshem”, ne ambjente te ndryshme nga ato te zonave doganore dhe qe nuk administrohen nga autoritetet doganore kushtezohet nga dhenia e autorizimit perkates.

2.2.2 Autorizimi per keto ambjente leshohet nga Drejtori i Pergjithshem i Doganave.

3. Procedurat per leshimin e autorizimit

Personat e interesuar per administrimin e ambjenteve te magazinimit te perkohshem duhet te depozitojne, prane zyres doganore kompetente per vendin ku ndodhen ambjentet ne fjale, dokumentacionin si me poshte:

kerkese me shkrim, sipas pikes 113.3 te te dispozitive zbatuese te Kodit Doganor.

- b) Dokumentacionin e regjistrimit dhe ate fiskal te personit juridik apo fizik te tatueshem (vendim e regjistrimit (QKR), Statutin, Akt-Themelimin, NIPT-it, etj) fotokopje te noterizuar.
- c) Planimetrine e ambjenteve (harte, skice ose gent-plan) origjinale ose kopje te noteruar.
- d) Dokumentacioni i pronesise se ambjenteve (vertetim pronesie, kontrate qiraje, kontrate perdorimi, etj) fotokopje te noteruar.
- e) Pasqyre e aktivitetit te meparshem ne kete lloj veprimtarie, ne qofte se ka pasur te tille, me pare.
- f) Informacion mbi masat e parashikuara per ruajtjen dhe administrimin e mallrave ne keto ambjente.
- g) **Garanci ne masen jo me pak se 4.000.000 leke, duke pasur parasysh edhe zbatimin e neneve 207 dhe 208 te Kodit Doganor.. Bejne perjashtim nga ky kusht, vetem rastet kur ambjentet administrohen nga ente publike ose shteterore.**

3.1. Kryetari i zyres doganore, me marrjen e kerkeses per autorizim nga operatori ekonomik I interesuar si dhe pasi shqyrton nevojën e zyres doganore per ambjente te magazinimit te perkohshem, organizon nje grup pune me jo me pak se tre punonjes (doganiere) per verifikimin e kushteve te ambjenteve te kerkuara per magazinimin e perkohshem te mallrave. Ky verifikim konsiston ne shqyrtimin e plotesimit te kushteve te meposhtme:

- a) largesise se ambjenteve nga zyra doganore (preferohet sa me prane),
- b) kushteve te sigurise (rrethimin dhe mundesine e mbylljes me 2 dryna ose plumbosje) se ambjenteve,
- c) mjeteve te nevojshme qe mundesojne kontrollin e mallrave (peshore, pirun, etj) n.q.s. disponon,
- d) ambjenteve te pershtatshme per pune te autoriteteve doganore (zyre), etj.

3.2. Mbi bazen e raportit nga grupi i verifikimit, kryetari i zyres doganore, brenda 2 javesh nga data e kerkeses per autorizim, pergatit mendimin me shkrim per miratimin ose jo te ambjenteve te kerkuara per magazinim te perkohshem dhe duke i bashkangjitur te gjithë dokumentacionin e paraqitur, e përcjell per ne Drejtorine e Pergjithshme te Doganave.

3.3. Mendimi i dhene nga kryetari i zyres doganore, se bashku me raportin e grupit te verifikimit dhe dokumentacionin e siperpermendur, merret ne shqyrtim nga Drejtoria e Procedurave dhe Vjeljes se Detyrimeve Doganore ne DPD.

Kjo drejtori, pasi e rishikon dokumentacionin ne fjale dhe nevojën ekonomike mbi bazen e kushteve dhe kriteret e nevojshme, pergatit Modularin e Autorizimit "Per ambjente te magazinimit te perkohshem" dhe i'a përcjell per miratim ose jo Drejtorit te Pergjithshem te Doganave.

3.4. Autorizimi miratohet per nje periudhe 1 vjecare.

Menjehere me miratimin e ambjenteve per magazinim te perkohshem, administratori duhet te paguaje nje tarife sherbimi vjetore ne **masen 400.000 leke** per te mbuluar shpenzimet administrative te autoriteteve doganore.

3.5. Kerkesa per ripërteritjen (rinovimin) e Autorizimit per Ambiente te Magazinimit te Perkohshem, behet nga administratori jo me vone se 15 dite perpare afatit te skadimit te periudhes se vlefshmerise.

3.6. Miratimi ose jo i Autorizimit te ri, kushtezohet nga raporti i Kryetarit te zyres doganore kompetente, per ecurine dhe problemet e mundshme qe kane dale gjate administrimit dhe inventaret e kryera, raport i cili i percillet Drejtorit te Pergjithshem te Doganave.

Drejtori i Pergjithshem i Doganave, ne rast te mospermbushjes se kushteve te percaktuara gjate administrimit, me kerkese te kryetarit te zyres doganore, shfuqizon autorizimin perkates dhe mallrave gjendje u caktohet menjehere nje destinacion doganor.

4. Evidentimi i mallrave dhe mjeteve te tyre te transportit qe ndodhen ne magazinim te perkohshem ne ambjente te autorizuar do te kryhet sipas procedurave te percaktuara ne piken 2.1. te ketij Udhhezimi, pra njesoj si per rastet kur vendqendrimi i mallrave ne magazinim te perkohshem, ndodhet ne zonat doganore.

4.1. Ne zbatim te pikes 115 te Dispozitive Zbatuese te Kodit Doganor, zyra doganore kompetente do te kryeje, se bashku me administratorin, inventaret per gjendjen fizike te mallrave dhe mjeteve ne ambjentet e magazinimit te perkohshem, cdo muaj.

Rezultatet e inventareve, do t'i dergohen Drejtorise se Pergjithshme te Doganave (Sektorit te Procedurave) brenda 5 diteve nga data e kryerjes se inventarit ne fjale.

5. Afati i qendrimit te mallrave ne statusin e magazinimit te perkohshem sherben per caktimin e nje destinacioni doganor (regjim doganor ose jo) per keto mallra.

5.1. Ne varesi te menyres se mberritjes keto afate jane: (neni 74 i Kodit Doganor)

- a) 10 dite nga dita e depozitimit te deklarates permbledhese per mallrat e mberritura ne rruge detare
- b) 5 dite nga dita e depozitimit te deklarates permbledhese per mallrat e mberritura ne rruge te ndryshme nga ajo detare (tokesore, ajrore, hekurudhore)

5.2. Ky afat fillon me mberritjen e mallrave ne territorin doganor shqiptar dhe depozitimin e deklarates permbledhese dhe regjistrimin e saj ne regjistrin e Magazinimit te Perkohshem. Perlllogaritja behet per cdo dite kalendarike. Ne rastet kur ky afat perfundon ne dite pushimi apo festa zyrtare afati shtyhet, automatikisht, per aq dite sa zgjat pushimi apo festa zyrtare.

5.3. Ne baze te nenit 74/2 te Kodit Doganor, autoritetet doganore mund te caktojne nje afat me te shkurter se ai i percaktuar me lart dhe qe gjykohet sipas rrethanave te meposhtme:

- a) natyra e mallrave te ndodhura ne magazinim te perkohshem paraqet rrezikshmeri per jeten, shendetin dhe ambjentin (si; karburante, lende plasese, lende helmuese ose me efekt toksik dhe radioaktivitet)
- b) kushtet e ruajtjes dhe sigurise se mallrave ne magazinim te perkohshem, momentalisht, jane te pamjaftueshme (ketu perfshihet edhe rrethana e mungeses se hapesires se mjaftueshme per qendrimin e mjeteve)
- c) kur autoritetet doganore gjykojne se, qendrimi i gjate dhe i pajustificuar i mallrave ne magazinim te perkohshem mund te perbeje shkak per shfaqje te elementeve abuzive apo shkelje ne fushen e legjislacionit doganor.

5.4. Autoritetet doganore te zyres kompetente, gjithashtu mund te autorizojne zgjatje te afateve te siperpermendura, ne kufijte kohore qe nuk tejkalojne nevojat reale te justifikuara nga rrethanat dhe konkretisht ne rastet si me poshte:

- a) kur per vete specifiken qe kane mallrat e mberritura me konteniere per te cilet, dorezimi i konteniereve dhe pronesia e mallrave ne te kushtezohen nga paraqitja e dokumentacionit original te transportit (Bill of Lading "B/L"),

kur caktimi i destinacionit doganor kushtezohet nga paisja me Autorizim, Leje apo license te posacme;

c) ne rastet e tjera te parashikuara ne aktet e tjera ligjore dhe nenligjore ne fuqi

Ne keto raste zgjatja e afatit te qendrimit do te miratohet per aq kohe sa duhet per paraqitjen e dokumentacionit te kerkuar.

6. Perpunime te lejuara per mallrat ne magazinim te perkohshem do te konsiderohen te gjitha ato masa apo operacione qe konsistojne ne sigurimin e ruajtjes ne gjendje te pandryshuar te mallrave duke ruajtur karakteristikat teknike dhe pa modifikuar pamjen e jashtme te tyre.

6.1. Kundrejt kerkeses me shkrim dhe te argumentuar prane kryetarit te zyres doganore, nga ana e personit te autorizuar per t'i dhene mallrave nje destinacion, gjate magazinimit te perkohshem te mallrave, mundet qe ne varesi te rrethanave:

a) te merren mostra (sipas nenit 67 te K.D.) nga personi i autorizuar me qellim saktessimin e deklarimit per caktimin e nje destinacioni;

b) te evidentohet paraprakisht sasia e mallrave te demtuara gjate rruges;

c) te behet i mundur transbordimi i mallrave nga njeri mjet transporti ne tjetrin per arsye te ndryshme qe gjykohen te drejta nga autoritetet doganore.

6.2. Keto verpme kryhen nga personi i autorizuar per te caktuar nje destinacion ne pranine e autoriteteve doganore dhe kundrejt dokumentimit me proces-verbal.

Nje kopje e ketij proces-verbali i bashkangjitet praktikës doganore dhe referencat e tij shenohen ne deklaraten doganore per destinacionin qe u caktohet mallrave.

7. Transaksionet tregtare brenda statusit të “mallrave ne magazinim te perkohshem”.

7.1. Statusi i mallrave ne magazinim te perkohshem lejon kryerjen e transaksioneve tregtare duke presupozuar qe mallrat janë jo shqiptare dhe për t'u bere të tilla duhet t'u nënshtrohen rregullave doganore te vendosjes ne qarkullim te lire apo destinacioneve të tjera doganore.

7.2. Te gjitha këto transaksione janë objekt i legjislacionit tatimor shqiptar dhe bëhen konform rregullave të tij dhe kundrejt paraqitjes se fatures tatimore te shitjes të miratuar. Në asnjë rast, autoritetet doganore, nuk mund të pranojne transaksione nen kosto.

8. Zbatimi i udhezimit

Ngarkohen Deget Doganore dhe strukturat e tjera doganore pergjegjese per zbatimin e ketij udhezimi.

9. Hyrja në fuqi

Ky Udhezim hyn ne fuqi menjehere.

Endri PEMA

DREJTORI PERGJITHSHEM

Konceptol: S. Sinani

Miranda: A. Nikshiqi

R. Gjoni

